



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-217
Datë 14.06.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 26.05.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa në Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, prej 26. 05. 2016 deri 26. 05. 2019 për këto kualifikime të aprovuara:

1.1. Teknik i kontabilitetit, niveli i KKK-së (IV).

1.2. Kontabilist i certifikuar, niveli i KKK-së (V).

1.3. Auditor i certifikuar, niveli i KKK-së (V).

1.4. Validimi i kualifikimeve dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- Planifikimi financiar për tre vitet e ardhshme.
- Plani i angazhimit të ligjëruesve të rregullt.
- Personave me nevoja të veçanta t'iu mundësohet një qasje e arsyeshme në certifikim.

- Shenjat sinjalizuese në objekt si dhe mjetet për fikjen e zjarrit të jenë të certifikuara me afat valid.
 - Të bëhet zhvillimi i procedurave për monitorim dhe mentorim.
- (Afati kohor: 31. 12. 2016)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 26.05.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacionet për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucion Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë.
Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa në Prishtinë; dhe
- AKK.


Kryetari i KD së AKK-së
Osman Buleshkaj